

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Te dhena te pergjithshme te shoqerise

Shoqeria "KLAJGER KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.32338 date 20.10.2004.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe statusit te saj.

Shoqeria "KLAJGER KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte shoqeri shqiptare me Administrator te saj Z. Sadik Lumi.

Ortaku i shoqerise eshte Z. Sadik Lumi i cili zoteron 100% te kapitali.

Kapitali i shoqerise eshte 107,210,000 leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Bathore 6, Kamez. Ajo eshte e regjistruar ne Drejtorine Rajonale te Tatimeve Tirane me Nr. NIPT-i: K51423028P.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale si dhe ne ndertimin e rrugeve, kanalizimeve ujesjellesave e veprave te artit.

Gjate vitit 2019 shoqeria e ka shtrire aktivitetin e saj edhe ne Kosove duke hapur dege edhe atje. Dega ne Kosove ka ushtruar aktivitetin e saj per periudhen Shtator-Dhjetor 2019 ne fushen e studimit shkencor te tokave bujqesore. Ashtu si ne Shqiperi edhe dega ne Kosove ka aksioner te vetem Z. Sadik Lumi. Pra mema eshte zoteruese 100% kapitalit te deges. Per kete periudhe ka plotesuar te gjitha detyrimet dhe ka hartuar pasqyrat financiare ne perputhje me legjislacionin ne kete shtet.

2. Permbledhja e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

• Menyra e pregatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pergatitur ne mbështetje të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Standartit Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 27, 28 dhe 31 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale si dhe LIGJIT Nr. 62/2014 Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit.

Data e raportimit te pasqyrave financiare si te memes edhe te deges jane te njejta perfshijne periudhe 01 Janar-31 Dhjetor 2019.

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pregatitur mbi bazen e kostos historike, me perjashtim te rasteve qe percaktohet ndryshe ne se ka te tilla.

- **Monedha funksionale dhe me te cilen paraqite pasqyrat.**

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL) e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e shoqerise. Informacioni financiar eshte i paraqitur ne Leke.

- **Vleresimi i likujditeteve**

Gjendja e likujditeteve perfshijne gjendjen e parave ne arke dhe ne llogarite rrjedhese ne banke ne leke dhe ne monedha te huaja, e vleresuar kjo me kursin e Bankes se Shqiperise ne dt. 31.12.2019.

- **Vleresimi i kerkesave per arketim**

Kerkesat per arketim vleresohen me vleren nominale te tyre

- **Vleresimi i detyrimeve te pagueshme ndaj furnitoreve**

Detyrimet ndaj furnitoreve jane te vleresuara mbi bazen e vleres se tyre nominale.

- **Huate**

Huate e marra me interes regjistrohen fillimisht me vleren e drejte. Pas njohjes fillestare jane te vleresuara me koston e amortizuar. Interesat e perlllogaritur jane njohur ne pasqyren

e te ardhurave dhe shpenzimeve si detyrim ne llogarine e interesave te perlllogaritura.

- **Veprimtarite ne monedhe te huaja**

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen ne kontabilitet me kursin e dates se kryerjes se transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj jane perkthyer ne pasqyren e bilancit me kursin e kembimit te Bankes se Shqiperise me dt.31.12.2019. Diferenca nga kursi i kembimit te lindura jane pasqyruar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

- **Vleresimi i gjendjes se inventarit**

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vend dhe kushtet ekzistuese.

- **Provizionet**

Nje provision krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultati i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mundet te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

- **Te ardhurat**

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbylluar kontabel, (pavaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes).Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Te ardhurat jane perfitimit ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregetare) te marrra gjate periudhes kontabel, si rezultat i rrjedhes normale te veprimtarise se njesise ekonomike raportuese, atehere kur keto perfitime ekonomike çojne ne rritjen e kapitaleve te veta.

- **Tatimi mbi fitimin**

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor.Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit dhe çdo rregull ne tatimet per tu paguar qe rrjedhe nga vitet e kaluara.

Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte 15% per te ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti ne Republiken e Shqiperise dhe 5% per te ardhurat e gjeneruara nga Dega ne Republiken e Kosoves, pasi per keto te ardhura eshte llogaritur dhe paguar 10% e tatimit mbi fitimin ne kete vend.

- **Fondi i pensioneve**

Shoqeria paguan kontribute per pensionet si dhe kontribute per sigurime shendetimore per punonjesit e saj sic eshte parashikuar ne legjislacionin social ne Shqiperi.Kontributet bazuar ne pagat jane paguar ne llogari te organizmave kombetare

pergjegjes per pagesan e pensioneve dhe shpenzimeve shendetsore. Nuk ka asnje detyrim tjetër ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendetsore.

3. Informacinin i hollesishem mbi llogarite

- Aktivitet monetare***

Gjendja e arkës dhe e bankës për këtë vit përfshin gjendjet e llogarive në Shqipëri dhe në Kosovë. Në shumën 57,364,473 lekë janë përfshirë 264,326.84 euro gjendje në llogaritë bankare dhe në arkë në Kosovë me kursin 121.77 të Bankës së Shqipërisë në 31.12.2019 dhe 25,177,394 lekë janë gjendja e bankës dhe e arkës në Shqipëri.

- Kërkesa të arketueshme***

Detyrimet e klienteve analitike

Nr.	Emertimi i llogarise	NIPT	VLERA E DETYRIMIT
1	All Gllas sh.p.k.	K21418005S	5,279,027
2	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural		2,285,904
3	Agjencia e Parqeve dhe Rекреacionit	L52205451C	198,086
4	BASHKIA KAMEZ	K51713031R	46,917,606
5	BASHKIA TIRANË	K11729002L	36,677,869
6	GJYKATA E APELIT TIRANË	K22409003F	84,807
7	KOMUNA TREBISHT	K46915407B	10,670
8	LIVADHI CONSTRUCTION	L62120019T	750,000
9	NY LB&H sh.p.k.	L81630020T	1,266,240
10	SHERBIMI KOMBETAR I RINISË	K31423028P	86,791
11	UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS	J61929020T	10,000
12	UJESJELLES KANALIZIMET SHA TIRANË	L72320033P	706,735
	SHUME		94,273,735

Përveç klienteve të mesipër në zerin e të drejtave të arketueshme është përfshirë edhe shuma prej **109,054,096** lekë që i referohet diferencës së pa arketuar nga shitja e apartamenteve dhe dyqaneve të pallatit me objekt: “GODINË BANIMI DHE

SHERBIMI 6+7 KATE+1 KATE NENTOKË” duke qene se kemi bere edhe shitja e perjashtuar me çmimin e references dhe e kemi mbyllur detyrimi nga ana fiskale.

Ne total e drejta e arketueshme shkon **203,327,831** leke.

- Te drejta te tjera te arketueshme ne shumen prej 2,114,938 leke ju referohet pagesave te bera furnitoreve kundrejt faturave te paradhenieve ne shumen prej 814,850 leke dhe gjendjes kreditore te TVSh ne 31.12.2019 ne shumen prej 1,300,088 leke.

- *Inventari*

Inventari ne 31.12.2019

Nr	Emertimi i Artikullit	Njesia	Sasia	Kosto	Vlera
1	RERE	m ³	18	1167	21,000
2	TULLA	COPE	5120	20	102,400
3	ÇIMETO	KV	70	820	57,400
	Shuma				180,800

- *Aktivet materjale*

Ne kete ze jane perfshire aktivet materjale (ndertesat, makinerite e pajisjet) me vleren neto te tyre sipas pasqyres se amortizimit qe ju bashkengjitet pasqyrave dhe ketyre shenimeve, te cilat per kete vit jane ne vleren 11,260,369 leke.

- **DETYRIME AFATSHKURTRA**

Ne zerin e “Detyrime ndaj institucioneve të kredisë” eshte pasqyruar shuma e overdraft-it te marre nga Banka Kombetare Tregtare (BKT) ne Shumen prej 8,610,000 leke.

- *Arketime ne avanc* ne Shumen 40131 I referohet shumes prej 329.56 Euro te arketuara ne anance ne Ministria e Pylltarise Kosove per Degen e Klajgerit ne Kosove.

- *Detyrime ndaj furnitorit*

Ne kete ze jane perfshire detyrimet ndaj furnitoreve te shoqerise ne Shqiperi dhe ne Kosove, nga shuma **50,433,449 leke** qe eshte detyrimi total **49,581,063 leke** jane

detyrime te furnitoreve ne Shqiperi sipas tabelës se meposhtme, ndersa **7.000 euro e vlefshme me 852,390 leke** i referohet detyrimit qe “Klajger Konstruksion Dega Kosove” i ka furnitorit “NBT-ING” sh.p.k Suhareke Kosove.

Nr.	Emertimi i llogarise	NIPT	VLERA E DETYRIMIT
1	ALLGLLAS sh.p.k.	K21418005S	177,600
2	ARJEIL sh.p.k.	K31320002L	24,464
3	ADVANCED	K81413042D	6,850,905
4	AGRON COLOR 07	K71723020I	972,128
5	BRITANIA sh.p.k	L02228018C	377,167
6	FERIT ISUFI		4,400,000
7	HODO-ALB sh.p.k.	L01308050F	628,830
8	ERZENI SH	J66902027T	456,640
9	LARTI sh.p.k.	J94316024A	1,132,461
10	MAKARESHI	K24725213C	1,552,722
11	METAL NESIMI	L31819009A	8,074,560
12	NAZMI KAZANI	K51529013B	1,981,820
13	PLLAKA&KOTARJA	L52227020O	237,586
14	RAFAELO 2002	K22113003Q	17,853,509
15	SHIJAKU	J64102272V	1,090,642
16	TERMO-MONT	J72015003E	1,348,482
17	VARAKU -E	J61902509S	181,044
18	WEISS PROFIL	K91321018A	2,240,503
	SHUMA		49,581,063

- “Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore” janë pasqyruar detyrimi per Sigurimet shoqerore te muajit Dhjetor 2019 ne shumen 876,381 leke per “Klajger Konstruksion” Shqiperi dhe detyrime per paga dhe sigurime pensionale ne shumen 9,158.22 euro ose 1,115,196 leke per “Klajger Konstruksion Dega Kosove” qe ne total pas konsolidimit paraqiten ne Shumen 1,991,577 leke.

-
- “Të pagueshme për detyrimet tatimore TVSH dhe Tatim fitimi” ne kete shume 4,469,869 leke eshte perfshire detyrimi per TVSH e muajit Dhjetor 2019 te “Klajger Konstruksion Dega Kosove” ne shumen e 8,465.87 euro ose 1,030,889 leke per Tatimet Kosove, si dhe Tatim Fitimi per vitin 2019 ne shumet perkatese 23,937.32 Euro ose 2,914,847 leke te “Klajger Konstruksion Dega Kosove” per Tatimet Kosove si dhe diferenca e Tatim mbi Fitimi ne shumen 7,016,096 leke me Shumen e kesteve te tatim fitimit te paguara gjate vitit per Drejtorine Rajonale te Tatimeve Tirane. Tatim Fitimi prej 7,016,096 leke per vitin 2019 e “Klajger Konstruksion” Shqiperi perfshin 5,558,673 leke qe i referohet detyrimit per aktivitetin ne Shqiperi ndersa 1,457,423 eshte diferenca e Tatimit Fitimit per fitimin e gjeneruar nga Dega ne Kosove (5% pasi 10% e tij eshte paguar ne Kosove)
 - “Të tjera të pagueshme” i referohet nje huaje te marre nga nje individ ne vitin 2015 ne difference shume 1,734,400 leke.
 - *Dividente per tu paguar.*

Shoqeria ka shperndare fitimin e vitit 2018 si dividend ne shumen 42,000,000 leke. Shume per te cilen ka derdhur tatimin mbi dividendin ne masen 8% e vlefshme me 3,360,000 leke dhe differences prej 38,640,000 leke e ka si detyrim per t’iu paguar ortakut per periudhat ne vazhdim.

- **DETAJIMI I SHIFRES SE AFARIZMIT**

Ne pasqyren e konsoliduar te ardhurave te shoqerise per kete vit jane perfshire **242,073,758 leke te ardhura nga aktiviteti neto ne Shqiperi** (dmth jane eliminuar te ardhurat brenda grupit ne shume e 230,000 euro ose 28,007,100 leke qe i referohet faturave te shitjes qe “Klajger Konstruksion” Shqiperi ka bere per Degen e saj ne Kosove) dhe 553,640.18 euro te vlefshme me 67,416,765 leke jane te ardhurat nga shitjet ne Kosove.

Gjithashtu ne pasqyren e te ardhurave per vitin 2019 eshte njohur si e ardhur edhe demshperblimi i marre nga Ministria e Financave lidhur me fitimin e nje ceshtje gjyqsore ne shumen prej 3,294,438 lekesh.

Duke i çuar te ardhurat ne total ne Shumen 312,784,960 leke.

- **Shitjet neto te detajuara**

Objekte te realizuara per periudhen 2019					
PERIUD HA	OBJEKTI	INVESTITORI	NIPT	Shitjet me 18%	Shitje me shkalle 20%
2018-2019	“Rikonstruksion pa ndryshim funksioni ne objektin ekzistues 2 kat me çati te pashfrytzueshme,ne prone te z.Engjellush Avdulaj me Leje ndertimi Nr.Prot. T-7696/8 miratuar me vendim te kryetarit te bashkise Nr.T-7696/8,date 30.05.2018	MULLIRI I VJETER	K72417027E		6,116,127
2018-2019	"Rehabilitim i pjesshem dhe instalimi i sistemit te ngrohjes ne shkollen 9-vjecare “Dhora Leka” FAZA E II	BASHKIA TIRANE	K11729002L		18,655,654
2019	NDERTIM RRUGA DRINI	BASHKIA KAMEZ	K51713031R		91,893,584
2019	NDERTESE BANIMI 1FAMILJARE - 2 KATE, NE PRONE TE MIRAXH & BESMIR LECI: PASKUQAN-KAMEZ	BESMIR LECI	Privat		8,333,333
2019	“Sisteme vëzhgimi dhe kontrolli me kamera”	Agjencia e Parqeve dhe e Rekreacionit	L52205451C		3,301,440
2019	Ndertim rruga Ostreni	BASHKIA KAMEZ	K51713031R		1,949,990
2019	GERMIM DHEU	DAED SH.P.K	K32803003L		34,000
2019	Rikonstr.rrugeve Blloku Lagja 1 Bathore	BASHKIA KAMEZ	K51713031R		29,621,840
2019	“Rikonstruksion i shkollës “Sabaudin Gabrani”	BASHKIA TIRANE	K11729002L		45,452,880
2019-2022	Programi kombëtar për inventarizimin e tokave bujqesore të Republikës së Kosovës për komunat Pejë, Klinë, Deçan, Istog dhe Junik Lot 1	MINISTRIA E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		67,416,765	
2019	Ndërtim Kopsht & Çerdhe e integruar, Kodër Kamëz	BASHKIA TIRANE	K11729002L		28,827,370
2019	“BLERJE SHËRBIMI PËR MIRËMBAJTJEN E OBJEKTEVE NDËRTIMORE TË BASHKISË TIRANË”	BASHKIA TIRANE	K11729002L		7,454,640
	SHUMA TOTALE			67,416,765	241,640,858

Adresa: BATHORE 6, KAMEZ,
Tel/Fax: +355 4 320 400/ 241 475
Mobile: +355 68 20 37 561
NIPT: K51423028P.

- **Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Tek zeri *Lenda e parë dhe materiale të konsumueshme* është zbritur shuma e faturave të blerjeve nga Klajger Konstruksion dega Kosove të bera nga Klajger Konstruksion Shqiperi (pra janë eliminuar llogarite me njesite brenda grupit). Siç u eliminuar të ardhurat brenda grupit janë eliminuar edhe shpenzimet brenda tij.

Shuma prej 193,483,323 leke përfshin 192,212,167 leke shpenzime për lende të parë e materjale të Klajger Konstruksion Shqiperi dhe 10,439.00 euro e barazvlefshme me 1,271,156 leke janë shpenzimet e Klajger Konstruksion Dega Kosove.

Ndërsa tek zeri *Të tjera shpenzime* Shumen prej 308,219 leke janë përfshirë 293,302 leke shpenzime të energjisë elektrike dhe 14,917 leke blerje kancelarish.

- **Detajimi i zërit "Shpenzimeve të tjera"**

PERSHKRIMI	VLERA
Mirembajtje dhe riparime	131,192
Siguracion makine AA484HR	52,282
Studime e kerkime	620,722
Shpenzime avokatie dhe tarifa ankimimi KPP	325,000
Sigurime ofertash dhe kontratash	196,720
Auditim pasqyrash	210,000
Shpenzime për reklama dhe publicitet	200,000
Shpenzime postare	23,639
Shpenzime AMC	23,872
Shpenzime doganore	29,364
Taksa dhe tarifa vendore	560,068
Transport dhe dieta e hoteleri	11,736,476
Gjoha dhe demshperblime	1,312,076
Shuma totale	15,421,411

- **Të ardhura dhe Shpenzime nga interesat**

PERSHKRIMI	VLERA
Shpenzimet	

Sherbime Bankare Banka Kombetare Tregtare Tirane	353,772
Sherbime Bankare Banka Kombetare Tregtare Peje	32,634
Sherbime Bankare Raiffeisen bank	6,471
Shpenzime per interesa kredie	498,070
Shuma totale e shpenzimeve	890,947
Te ardhurat	600
Diferenca	-890,347

- Fitim (Humbjet) nga kursi i kembimit**

PERSHKRIMI	VLERA
Shpenzimet	
Humbje nga konvertimi	49,860
Te ardhurat nga konvertimi	517,935
Diferenca	468,076

- Shpenzime te panjohura**

PERSHKRIMI	VLERA
Gjoha dhe demshperblime nga inspektoriati I ndertimit Tirane	1,312,076
Shuma totale	1,312,076

- AMORTIZIMI**

Lidhur me analizen e zerit te Amortizimeve deklarojme se llogaritja eshte bere sipas specifikimeve te paraqitura ne pasqyren e amortizimeve e bashkengjitur.

- KOSTO E PUNES**

Per sa i perket pasqyrimet te shpenzimeve lidhur me punonjesit si me pagat, sigurimet shoqerore, TAP nje sqarim te hollesishem paraqet **"Pasqyra permbledhese e pagave dhe Sigurimeve"** bashkengjitur.

- Konkluzionet**

Ne perfundim te ketij raporti rezultati financiar per vitin ushtrimor 2019 eshte fitim (para tatimit) ne masen 64,894,216 leke, nga i cili fitim i realizuar nga Klajger Konstruksion Dega Kosove ne shume 239,373.19 euro ose 29148473.35 leke dhe Fitimi i realizuar nga Klajger Konstruksion Shqiperi 35,745,742.6 leke,

pas zbritjes se tatimit mbi fitimin ne shumen 9,930,944 leke nga i cili 7,016,096 leke i paguar ne Republiken e Shqiperise dhe 23,937.319 euro e barazblefshme me 2,914,847.3 leke te Paguar ne republiken e Kosoves Fitimi Neto llogaritet 54,963,272 leke.

Pas ketij viti kapitali i shoqerise shkon ne **168,328,985 leke.**

Per te dhena me te hollesishme lidhur me treguesit ekonomik financiar qe ka arritur shoqeria gjate vitit ushtrimor 2019, subjektet e interesuara mund te ju referohen pasqyrave financiare dhe atyre sipas udhezimit te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

**Administratori i Shoqerise
"KLAJGER KONSTRUKSION" sh.p.k.
SADIK LUMI**

**HARTUESJA E PASQYRAVE
MARJETA UJKASHI**

Tirane me 21.03.2020
Prot.kk.md.180327/090

DEKLARATE

Deklaroj se Shoqeria "KLAJGER KONSTRUKSION" sh.p.k. me NIPT:K51423028P me Administrator Z.Sadik LUMI dhe aksioner :

- 1. Z.Sadik LUMI perqindja e pjesmarrjes 100%**

ka hartuar pasqyrat financiare te vitit 2019 konform standarteve kombetare te kontabilitetit.

Hartuesja e pasqyrave financiare eshte :

Znj. MARJETA DEMA (UJKASHI) ekonomiste e punesuar prane shoqerise.

**Administratori i Shoqerise
"KLAJGER KONSTRUKSION" sh.p.k.
SADIK LUMI**